



Partia Demokratike

Nr. 64/11 Prot.

Tiranë, më 10.05.2022

KËRKESË

- KËRKUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë
Komisioni i Rithemelimit
- DREJTUAR :** Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë
Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë
- OBJEKTI:** Fillimin e hetimit dhe paraqitjen e kërkesës për marrjen e masës disiplinore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të “*pezullimit nga detyra*” për gjyqtaren pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Blerina Muça, dhe në përfundim të hetimit nga ana Juaj, të kërkonti pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor “*Shkarkimin nga detyra të gjyqtarës Blerina Muça*” për shkak të shpërdorimit rëndë të detyrës
- BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr.84/2016 “Për Vlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

I Nderuar z. Metani,

Komisioni i Rithemelimit, me cilësinë e kërkuarit ju bën me dije se ky komision është i vetmi organ drejtues i Partisë Demokratike, bazuar në Kuvendin e kësaj partie më datë 11 dhjetor 2021 dhe pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr.3 datë 25 mars 2022.